



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit

01/Nr. 2534 / 2026
Data: 13.03.2026

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e dytë -II- për vitin 2026 e Komitetit për Politik dhe financa, mbajtur me datë 18.02.2026 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetarë i Komunës), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim), **Kimete Kuka - Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoresh për Kulturë, Rini dhe Sport), **Senad Kalisi** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Bajrush Laçi** (Udhëheqës i Zyrës Ligjore), **Sevime Bajrami** (Kryesuese e Komisionit të Aksionarëve të kompanisë NLP Pastrimi), **Amir Bushi** (Udhëheqës i Zyrës për Punë Sociale), **Vjosa Rogaçi** (Zyrtare për Barazi Gjinore), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2025.
3. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2025.
4. Propozim vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm të pronës së paluajshme.
5. Plani i biznesit të N.P.L Pastrimi sh.a për vitin 2025.
6. Raporti financiar për vitin 2025 i N.P.L "Pastrimi" sh.a.
7. Raporti i punës për planin lokal të veprimit për barazi gjinore për vitin 2025.
8. Raporti i ekipit komunal për të drejtat e fëmijëve në Han të Elezit.
9. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.
10. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATU RENDI I PUNËS

1. Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjani thekson: në këtë raport janë përfshirë gjitha aktivitetet dhe punët e Kryetarit në harmonizim me planifikimet buxhetore të vitit 2024. Përveç materialit të cilin e kam përcjellë, diçka të veçantë nuk kam.

Menduh Vlashi thekson: raporti del prej planit të punës dhe planin e punës nuk e kam parë. U mundova përmes ueb-faqes, por nuk munda me gjet. Kërkoj nga ekzekutivi që ueb-faqja të jetë më e furnizuar, se mungojnë shumë gjëra, sepse ne dokumentacionin e komunës mund ta gjejmë vetëm përmes ueb-faqes, por me gjithë atë është bërë një punë mjaft e mirë dhe te disa drejtori më mirë. Mirëpo kam disa vërejtje të përgjithshme të raportit, ndërsa në detale do të hyj në Kuvend. Është mirë që të gjitha materialet me i shënuar me numra faqet për shkak të punës më të lehtë në Kuvend. Kur është emëruar drejtori i shërbimeve publike, z. Senad Kalisi, e di që është emëruar shumë vonë dhe raportin është dashur me bërë drejtori i mëhershëm. Raporti duhet të përmbajë krahasime të viteve. Te disa drejtori shoh që ka krahasime shumë pak, te disa fare. Vërejtje kam se shumë drejtori shënojnë të njëjtën gjë, drejtoria me drejtorinë tjetër, dhe nëse një drejtori e ka shënuar, nuk ka nevojë me shënuar sektori tjetër. E kam vërejtur në raport se shumë drejtori i duplikojnë të dhënat.

Visar Hasallari thekson: për shfrytëzim të automjeteve zyrtare për vitin 2024 figuron që janë 542 kërkesa dhe janë diku 123280 km, ndërsa në vitin 2025 kemi 487 kërkesa dhe 128761 km, pra kemi rritje. Kërkoj sqarim për këtë çështje. Te procedurat e rekrutimit të shërbimit civil është një farë mospërputhje në raport, se disa pozita figurojnë që janë të shtuara dhe nëse merret faqja e agjensionit për burime njerëzore, që është për tërë Republikën e Kosovës, del se realizimi është i dështuar, a në fakt janë të realizuara. Më herët ka qenë më mirë, se në ueb-faqe të komunës ke mundur me i gjetur të gjitha dokumentet që kanë qenë të miratuara në kuvend, por tash është problem. Është mirë me na treguar mekanizmin se si me i gjetur.

Sevdi Dernjani thekson: ne e kuptojmë shumë mirë që raporti bëhet në bazë të planifikimeve buxhetore të vitit 2024 dhe planit të punës së kryetarit për vitin 2025 e këtu nuk mundemi sipas dëshirës së gjithë secilit me nxjerrë raportin e kryetarit apo drejtorive për kërkesat e caktuara që mundën me ardhur prej anës së jashtme. Pajtohem me atë që potenconi që i mungojnë numrat, por nuk po mundem me u pajtuar me atë që potenconi që ka duplikim të gjërave. Është mirë që t'i potenconi konkretisht se cila drejtori. Te puna e planit të kryetarit të komunës nuk e di që mungon, por faqja e komunës ka ndryshuar, por saktë nuk e di se në cilin vit, dhe nuk është ajo faqe që është përdorur më herët. Zyrtari për transparencë mundet me na njoftuar se a është plani i punës apo nuk është. Nuk është sfidë për me gjetur një dokument të caktuar për një çështje të caktuar, por është mirë të adresohet në ueb-faqe që janë të gjitha dokumentet, apo ndoshta jeni duke kërkuar në ueb-faqe të mëhershme.

Bashkim Sopa thekson: më duhet me verifikuar çështjen e planit.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2025 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

2. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2025.

Kryesuesi thekson: materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Menduh Vlashi thekson: e kam një vërejtje të vogël që mendoj që është gabim teknik, që shënon se mbledhjet e kuvendit kanë qenë të hapura për publikun, por edhe pse vazhdimisht i kemi njoftuar qytetarët për një të drejtë të tyre për pjesëmarrje, kemi pas raste ku qytetarët kanë marrë pjesë në mbledhje të kuvendit. Na mbetet për detyrë që në vitin 2025 t'i inkurajojmë qytetarët që të marrin pjesë në punimet e kuvendit, pra mendoj që duhet të përmirësohet dhe të jetë për vitin 2026. Nuk e kam kuptuar Propozim vendim për shqyrtimin e raportit të studimeve dhe evidentimit të vlerave të trashëgimisë natyrore në territorin e Komunës së Hanit të Elezit, të propozuara nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

Nexhmedin Daci thekson: Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e trashëgimisë së Natyrës vitin e kaluar, së bashku me zyrtarët tanë, kanë evidentuar do vlera të trashëgimisë natyrore në Han të Elezit dhe e kanë kryer elaboratin dhe me Ligj kërkohet që të mbahet debat publik, i cili do të mbahet me datë 03.03.2026 e pastaj i drejtohem i Ministrisë së Planifikimit Hapësinor për pëlqim për me i miratuar propozimet e institutit për vlerat e trashëgimisë natyrore. Nëse Ministria na i jep pëlqimin, në Kuvend do të procedohet për miratim. Bëhet fjalë për katër vlera të trashëgimisë kulturore, vendi i quajtur Skallavaci, ujëvara te ish-kazerma e TMK-së dhe dy drunjë.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2025 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Propozim vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm të pronës së paluajtshme.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson: fjala është për parcelën e cila është në kuadër të oborrit të Komunës për me shpall me interes të përgjithshëm, e cila është pronë e z. Driton Luri. Për ndryshe drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka planifikuar ndërtimin e tregut të gjelbërt të qytetit. Komuna edhe më herët ka pasur në plan për me shpronësuar, por nuk është realizuar, por shpresojmë që në këtë vit t'ia kthejmë këtë pronë komunës.

Menduh Vlashi thekson: një vendim është marrë nga Kuvendi i Hanit të Elezit për këtë parcelë dhe a duhet të anulohet ai vendim për me marrë një vendim tjetër, sepse bëhet duplikim i vendimit për të njëjtën parcelë. Është mirë që materialit me ju bashkangjitur edhe fotoja, në mënyrë që të dihet se ku është kjo parcelë.

Nexhmedin Daci thekson: edhe unë kam menduar që ekziston vendim, por nuk kemi mundur me gjetur askund që është i shpallur me interes të përgjithshëm, sepse ka shumë parcele, por kjo parcelë nuk ishte.

Menduh Vlashi thekson: ai vendim është marrë shumë herët, që atëherë unë kam qenë Kryesues dhe ka qenë parcela e z. Qamush Brava dhe kjo parcelë.

Nexhmedin Daci thekson: parcela e z. Qamush Brava është, por kjo parcelë nuk është. Në vitin 2010 ka qenë një marrëveshje në mes Kryetarit dhe pronarit që në afat prej dy viteve për me shpronësuar, por nuk është shpronësuar. Pastaj ne e kemi një marrëveshje që për tri vite ka dhënë pëlqim për shfrytëzim.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U PROPOZIM VENDIMI PËR SHPALLJEN ME INTERES TË PËRGJITHSHË TË PRONËS SË PALUAJTSHME QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Plani i biznesit të N.P.L Pastrimi sh.a për vitin 2025.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevime Bajrami thekson: përveç materialit të cilin e kam përcjellë, diçka të veçantë nuk kam.

Menduh Vlashi thekson: sa i përket planit të biznesit të N.P.L Pastrimi sh.a për vitin 2025, më ka pëlqyer si plan. Në faqe dhjetë potencohet se në mënyrë që të arrihet objektivi (I) të zgjerohet grumbullimi i mbeturinave nga niveli aktual, i cili është 100 % e grumbullimit të mbeturinave në 100 % të të gjithë gjeneruesve të mbeturinave. Pikën 8.1 në faqe dhjetë, shërbimet e propozuara të grumbullimit të mbeturinave. Kërkoj sqarim. Janë paraqitur asetet, por është dashur me potencuar se kur janë blerë apo janë donacione.

Sevime Bajrami thekson: për mbledhje të kuvendit do t'i përmirësojmë.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U PLANI I BIZNESIT TË NPL PASTRIMI SH A PËR VITIN 2025 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Raporti financiar për vitin 2025 i N.P.L "Pastrimi" sh.a.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevime Bajrami thekson: përveç materialit të cilin e kam përcjellë, diçka të veçantë nuk kam.

Menduh Vlashi thekson: raporti është hartuar mirë, por vërejtje kam se në plan të punës shënon dy shoferë, ndërsa këtu shënon tre shoferë. Është mirë që të shënohen kontratat familjare sa janë në këtë vit dhe sa kanë qenë vitin e kaluar. A janë duke rënë kontratat familjare apo janë duke u rritur, sepse për vitin 2025 shënon që është rritur, ndërsa janë duke u zvogëluar familjet, por është mirë me treguar se sa kontrata janë shtuar.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN 2025 I NPL PASTRIMI SH A QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7. Raporti i punës për planin lokal të veprimit për barazi gjinore për vitin 2025.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Vjosa Rogaçi thekson: të bashkangjitur i keni aktivitetet e drejtorive të cilat kanë qenë pjesë e planit. Deshta mu lidh me një pyetje e cila u parashtrua më herët për përsëritjen e të njëjtit informacion, për shkak se plani për barazi gjinore e përfshin drejtorinë e arsimit, aty detyrohemi me përshkruar se sa kanë qenë përfitues të gjinisë femërore dhe sa kanë qenë përfitues të gjinisë mashkullore dhe për atë arsye është bërë dy herë i njëjti informacion.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI PËR PLANIN LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE PËR VITIN 2025 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

8. Raporti i ekipit komunal për të drejtat e fëmijëve në Han të Elezit.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Amir Bushi thekson: është Ligji për të drejtat e fëmijëve, i cili është miratuar në vitin 2019 dhe më 2020 ka hyrë në fuqi dhe sipas këtij ligji komunat janë të obliguara që ta krijojnë një ekip për të drejtat e fëmijëve dhe komuna jonë e ka themeluar këtë ekip. Materialin për raportin e ekipit komunal për të drejtat e fëmijëve në Han të Elezit e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson: si ekip a keni ndërmarrë diçka.

Amir Bushi thekson: si ekip fillimisht i kemi mbajtur takimet e rregullta dhe disa prej akterëve i kanë bërë disa raportime për punën e tyre të cilën e kanë bërë gjatë gjithë kohës. Në këto raporte përfshihen të gjitha aktivitetet të cilat bëhen gjatë gjithë vitit. Jemi fokusuar në parandalim, sepse nëse raportohet ndonjë rast i fëmijëve delikuentë, qendra për punë sociale e ka obligim ligjor për me trajtuar atë rast, por ne zakonisht e kemi parandalimin. Një çështje që duhet me u vlerësuar në raport është se jemi ndër komunat që prijmë me vlerësim të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Komisioni jonë ka qenë shumë aktiv për me i verifikuar fëmijët me nevoja të veçanta dhe tash kemi asistente nëpër shkolla dhe po punojnë me ta dhe kemi një avancim shumë të mirë në trajtimin e tyre.

Menduh Vlashi thekson: këtu shkruan raport dhe po mos të ishte pasuesi i fundit që potencon se këto janë aktivitete të realizuara për përmbushjen e objektivave strategjike, kjo më shumë i ngjan një plani të punës se sa një raporti. Është dashur në raport mi potencuar se sa inspektive janë bërë në këtë vit dhe sa janë bërë në vitin e kaluar dhe çka është gjetur, sepse nuk shënon që është gjetur mirë apo është gjetur keq. Shënon që kemi mbajtur ligjërata në shkollat fillore, është dashur me i cekur se sa ligjërata janë mbajtur. Mbajtja e fushatave vetëdijesuese është dashur me u shënuar se sa janë mbajtur.

Amir Bushi thekson: nuk kemi pasur të dhëna të sakta, se edhe më herët potencova se disa kanë raportuar e disa jo dhe pasi që nuk kemi pasur të dhëna, e kemi bërë si të përgjithshëm.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI I EKIPIT KOMUNAL PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE NË HAN TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

9. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson: vitin e kaluar gjithsej kanë qenë 27 aplikime për legalizim, kryesisht bëhet fjalë për shtëpi individuale. 18 janë legalizuar, kemi inkasuar të hyra prej 2500 €, ndërsa nëntë aplikues janë në listë të pritjes për shkak të problemeve të cilat i kanë me pronat. Në vitin e kaluar, me datë 31 dhjetor, ka përfunduar vlefshmëria e Ligjit të Legalizimit, por në muajin janar Ministria e Planifikimit Hapësinor na ka njoftuar me vendimin e ri që zgjatet afati i legalizimit edhe për këtë vit deri më 31 dhjetor 2026.

Menduh Vlasi thekson: sa i kushton qytetarit një metër katror i shtëpisë për legalizim.

Nexhmedin Daci thekson: disa çmime janë fikse dhe dihen, sidomos taksa administrative e cila është e përcaktuar me Ligj. Për shtëpi individuale është një euro për metër katror, dy euro është për objektet komerciale. Te shërbimet kadastrale Ligji i Legalizimit i ka thjeshtësuar në krahasim me Ligjin e mëhershëm. Kërkohej një raport i gjeodezisë dhe, me të dëgjuar e kam se vitin e kaluar dikush e ka bërë një euro metrën katror, por krejt varet nga gjeodeti dhe personi i cili bën marrëveshje me gjeodetin. Kërkohej një deklaratë prej pronarit.

10. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson: a keni ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 12:35.

Procesmbajtësi

Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit

Florim Shkreta

